

VENDIM
Nr. 200, datë 7.4.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM I BLOKUT TË BANESAVE TË KUFIZUAR NGA
BULEVARDI ‘ÇAMËRIA’, RRUGA ‘PELIVAN LESKAJ’, RRUGA ‘PIRO SAVA’ DHE
RRUGA ‘KUJTIM BEQIRI’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i bllokut të banesave të kufizuar nga bulevardi ‘Çamëria’, rruga ‘Pelivan Leskaj’, rruga ‘Piro Sava’ dhe rruga ‘Kujtim Beqiri’”, Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 36 852 455.36 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 36 852 455.36 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Vlorë, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM I BLOKUT TË BANESAVE TË KUFIZUAR NGA BULEVARDI ‘ÇAMËRIA’, RRUGA ‘PELIVAN LESKAJ’, RRUGA ‘PIRO SAVA’ DHE RRUGA ‘KUJTIM BEQIRI’, BASHKIA VLORË

PRONARI		TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM						SHËNIME		
Nr.	Pronari	ZK	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Volum	faqe	Truall m ²	Ndërtesë m ²	Sipërfaqe Truallit	Çmimi i truallit lek/m ²	Vlera e truallit, lek	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lek/m ²	Vlera e ndërtimit, lek	Vlera e truall dhe ndërtesë	KUFIZIME SIPAS KARTELËS SË PASURISË	Adresa
1	Spiro Andon Trifoni	8602	27/90-ND	Ndërtesë	9	64		50		10,903.00	0	50	77,514.20	3,875,710.00	3,875,710.00	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë C. Të drejtat reale; nr. regj. bosh, datë 1.8.2014, shteti është pronar i pasurisë 27/40-T vol. 9 faqe 57 mbi pasurinë 27/40-ND. D. Kufizimet e pronësisë: me nr. 00004255, datë 1.8.2014. Në bazë të vërtetimit të faktit juridik nr. 384 Andon Trifoni ka në pronësi pasurinë nr. 27/90-ND.	Vlorë
2	Albana Piro Çela	8602	27/90+1-2	Apartament	6	79		70		10,903.00	0	70	77,514.20	5,425,994.00	5,425,994.00	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë	Vlorë
3	Berta Meçani, Kastriot Meçani, Robert Meçani, Natasha Likaj, Suzana Meçani	8602	27/28+1-1	Apartament	8	72	0	56.8		10,903.00	0	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,402,806.56	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë	Vlorë
4	Antoneta Hashi Luloj	8602	27/28+1-3	Apartament	8	74	34.4	56.8	34.4	10,903.00	375063.2	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,777,869.76	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m ² truall	Vlorë
5	Andon Spiro Trifoni, Dhimitraq Andon Trifoni, Kristina Stefan Trifoni, Lorenc Andon Trifoni, Margarita Andon Trifoni, Spiro Andon Trifoni, Suzana Iliq Trifoni	8602	27/28+2-5	Apartament	8	76	0	56.8		10,903.00	0	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,402,806.56	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë	Vlorë
6	Aferdita Skenderi, Ali Hashi Skenderi, Arjan Skenderi, Artur Skenderi	8602	27/28+2-6	Apartament	8	77	0	56.8		10,903.00	0	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,402,806.56	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë	Vlorë
7	Albana Piro Çela	8602	27/28+2-7	Apartament	8	78	35.2	56.8	35.2	10,903.00	383785.6	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,786,592.16	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë. Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 35.2 m ² truall	Vlorë
8	Tatjana Muharrem Hoxhaj	8602	27/28+2-8	Apartament	8	79	34.4	56.8	34.4	10,903.00	375063.2	56.8	77,514.20	4,402,806.56	4,777,869.76	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë. Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m ² truall	Vlorë
Vlera totale e shpronësimit															36,852,455.36		